Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Burim Zeka	**01.09.2023**	**11.09.2023**	**2023/0605**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 22.08.2023, **OE "DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K."-** Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0605, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Shërbime te Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit ne objektet Policore."** me nr. të prokurimit: **"214-22-5200-2-1-1",** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: kontratë publike kornizë, me një operator ekonomik shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **379,614.27 €**.

Lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0283 i dt: 24.07.2023.

Fazat e procedurës se prokurimit:

Njoftimi për kontratë.....10.06.2022;

Procesverbali i hapjes së ofertave.....15.02.2023;

Njoftimi mbi vendimin e AK-së.....28.04.2023;

Kërkesa për rishqyrtim 03.05.2023;

Vendimi i AK-së në kërkesë për rishqyrtim.....11.05.2023;

Ankesa ne OSHP.....22.05.2023;

Vendimi i OSHP-se ne ankese 2023/283.....24.07.2023;

Njoftimi mbi vendimin e AK-së.....10.08.2023;

Kërkesa për rishqyrtim 11.08.2023;

Vendimi i AK-së në kërkesë për rishqyrtim.....15.08.2023;

Ankesa ne OSHP.....22.08.2023;

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik. Neni 4 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Neni 6 Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik. Neni 7 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Neni 9 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik. Neni 10 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

Neni 13 të Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative

Neni 47 par.3 të Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative,

Neni 48 par.1 pika 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6 të Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative,

Neni 48 par.2 të Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Fillisht paraqiten pretendimet e përgjithshme të procesit të tendërimit që konsiderojmë se nuk janë respektuar nga AK, të cilat do ti listojmë si në vijim:

AK, me njoftimin e dt.10.08.2023 ka anuluar në tërësi procesin e tenderimit "Shërbime të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimti në Objektet Policore", me numër të prokurimit 214-22-5200-2-1-1, me arsyetimin se AK, "ka kontaktuar" me ministrine perkatese dhe kinse te njejtin kane konfirmuar se produkti i ofruar per repelent nuk eshte i lejuar si substance primare me 28 %, mirepo po kjo nje gje absurde nga ana e AK, si Oe ankuese kemi pasur leje të përdorimit të sulfurit me 28 %, deri me datën 21.06.2023, të lëshuar nga MMPHI, ku edhe jemi shpallur fitues të këtij tenderi, po ashtu aryetimi i AK, bije në kundërshtim me arsyetimin e vendimit të OSHP-së, për arsye sepse OSHP, thotë që sulfuri është i ndaluar, kurse AK, thotë që sulfuri me 28 % është i ndaluar, gjë që të dy e kanë gabim edhe AK edhe OSHP, për arsye se gjatë gjithë kësaj kohe ne si Oe ankues kemi poseduar lejen për sulfur, përkatësisht produkt për repelent me përberje të sulfurit dhe për këtë është bërë importi i produktit, (*Vendim për leje të importit nga MMPHI Nr.22/2940/-1-ZSP/411/22 Datë 15.06.2022*), vlen të ceket se në bazë të këtij vendimi për leje të importit edhe është bërë importimi i produktin

me të cilin edhe kemi fituar tenderin, kurse leja e importit ka qenë valide deri me datën 21.06.2023, kurse tenderi është fituar brenda kohës së vlefshmërisë së lejes së importit (dt.27.04.2023 shpallemi fitues), po ashtu AK fillimisht edhe dashur te bashkengjitet dokumenti zyrtar i komunikimit me ministrine perkatese, po ashtu edhe si OE Fitues, Autopritetit Kontraktues ju kemi drejtuar me email me dt.10.08.2023, për të kërkuar deshmin me shkrim nga ministria perkatese se kinse sulfuri nuk mund të përdoret në lëmin e DDD-së, mirëpo deri në ditën e parashtrimit të ankesës jemi pa përgjigje lidhur me kërkesën tonë pra AK na ka injoruar.

Po Autoriteti Kontraktues në faqen 3 të vendimit të dt.15.08.2023, ka bashkëngjitur një pjesë të dokumentit "Material Safety Data Sheet" për produktin sulfur (CASH#7704-34-9) N/A 10.00 %, i cili dokument është pikërisht leja e Importit "Material Safety Data Sheet", për produktin që ne kemi aplikuar.

Autoriteti Kontraktues ka dështuar të veprojë sipas nenit 7 par.1 të LPP-së, në të cilin përcaktohet se "*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*" lidhur me par. 2 të njëjtit nen dhe ligj ceket se "*Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik*", pasi që gabmimisht ka ardhur në një përfundim të tillë për arsye se asnjë nga substancat nuk janë të ndaluara sipas ECHA apo European Chemical Agency (Agjencia Europiane Kimike) nga linku që vet Ekspertër e ka bashkangjitur po edhe nga e-mail MMPHI-së, në Raportin e Ekspertizes (faqe 26, 27 dhe 28 të raportit të ekspertit shqyrtues). Nga hulumtimi dhe kërkimi i po këtij linku në internet rezulton se këto substanca nuk janë të ndaluara që eksperti aludon se janë të ndaluara, asnjëra nga këto substanca nuk janë të ndalura sipas ECHA apo European Chemical Agency (Agjencia Europiane Kimike), ndërsa janë të Aprovuar nga Bashkimi Europian - approved by the European Union. Po ashtu ekspertet e organit shqyrtues të prokurimit kanë bashkëngjitur direktiven apo rregulloren me Nr.1062/2014, është rregullore e cila si e tillë nuk ekziston.

Në Linkun (https://echa.europa.eu/information-on-chemicals/biocidal-active-substances) që ekspertet kanë bashkangjitur, rezulton që asnjëri nga substancat nuk janë të ndaluara sipas ECHA (Agjencia Europiane Kimikale). Gjithashtu edhe nga e-mail MMPHI njofton ekspertet se preparatet me substancë active janë të lejuara prandaj MMPHI dhe i ka dhënë lejen e importit OE fituese.

Gjithashtu hulumtimi në internet në linkun ECHA (https://echa.europa.eu/information onchemicals/ biocidal-active-substances) që ka bashkangjit ekspertat për substancat shihet se asnjë nga këto substanca nuk janë të ndaluara. AK eshte dashur të bejë hulumtime e nevojshme dhe te vertetoj ne baze nje hulumtimi te thjesht se sulfuri nuk eshte substance e ndaluar qe konstatohet edhe nga linku i bashke ngjitur, pra nuk eshte i ndaluar as ne Kosove

edhe as ne BE.

Sipa të dhënave të cilat janë shumë lehtë të verifikueshme po ashtu bazuar në atë se ECHA (Agjencia Europiane Kimikale), asnjëherë nuk e ka ndaluar përdorimin e sulfurit për lëminë e DDD-së, por edhe në Kosovë një gjë e tillë nuk është ndaluar këtë më së miri e konstaton dokumenti "Material Safety Data Sheet" që OE ankues tani posedon edhe me vazhdimin e lejes së përdorimit të sulfurit, që është i regjistruar nga ne, para se të merr vendim AK dhe OSHP, që do të thotë se sulfuri nuk ka qenë i ndaluar asnjëher dhe as sasia e tij e cila tani sipas lejes së re është 10 %.

Gjithashtu hulumtimi në internet në linkun ECHA (https://echa.europa.eu/information-onchemicals/biocidal-active-substances) që ka bashkangjit ekspertat për substancat shihet se asnjë nga këto substanca nuk janë të ndaluara në paragrafin **HULUMTIMI.**

Andaj konsiderojmë se asnjë nga këto substanca nuk janë të ndaluara sipas hulumtimit në internet ECHA apo European Chemical Agency (Agjencia Europiane Kimike) në linkun (https://echa.europa.eu/information-on-chemicals/biocidal-active-substances) që ekspertet kanë bashkangjitur po edhe nga e-mail i MMPHI-së, që ka njoftuar ekspertet, gjithashtu OE ankues në dosje ka paraqitur lejet e importit nga MMPHI. Po ashtu vlen të ceket se në kërkimin në internet ECHA apo European Chemical Agency (Agjencia Europiane Kimike) në linkun e lartë cekur për çdo produkt aktiv të OE ankues që të gjitha janë produktet në legjendën në të majtë se janë të aprovuara nga Unioni Evropian, pra approved by the European Union, dhe kjo duhet të bazohet vetëm tek opsionet "Disinfectants" dhe "Pest Control", që janë me legjenden e aprovuar dhe që kanë të bëjnë me fushë veprimtarinë e OE ankues por edhe të tenderit të shpallur dhe të fituar nga OE ankues.

Po ashtu përmes kësaj ankese kërkojmë që espertët e Organit Shqyrtues të prokurimit që kanë punuar Raportin e Ekspertizës me numër të lëndës 2023/0283 të dt.16.06.2023, të mos angazhohen për këtë rast përseri për arsye se në vetë linqet që kanë bashkëngjitur këta ekspert vërtetohet se asnjë nga produketet nuk ka qenë të ndaluara në lëminë e DDD, kurse të njëjtit i kanë paraqitur si produkete të ndaluara, po ashtu vlen të ceket se të gjitha produktet e cekura nga ekspertet sipas ECHA nuk janë të ndaluara, që ekspertizën e tyre e bëjnë tendencioze dhe të dyshimet, sepse nuk mund të ketë produkte të ndaluara në Kosovë dhe as BE, kur vetë OE Ankues posedon me leje të përdorimit të regjistruara të këtyre produkteve dhe është bërë importi i produktit.

Me lartë u sqaruar shkeljet e përgjithshme lidhur me proceduren e tenderimit, kurse më poshtë do të paraqesim shkeljet e radhës të AK, në lidhje me ligjshmerinë e vendimit, përkatësisht kundërligjshmërinë e tij.

Mbështetur në nenin 47 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative është përcaktuar Struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar, përkatësisht në paragrafin 1.3 të këtij neni përcakton se si element i detyrueshëm i aktit administrativ është pjesa arsyetuese e tij, duke pasur parasysh këtë rëndësinë e arsyetimit të një akti administrativ e sanksionon edhe neni 48 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme

Administrative, në të cilin përcaktohet se: "1. *Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:*

1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës;

1.2. ***shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;*** *1.3.* ***shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;***

1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret;

1.5. ***shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve****;*

1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim."

Lidhur me paragrafin 2 të po të njëjti nen dhe ligj përcaktohet se: "Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.", në këtë dispozitë ligjore shumë qartë theksohet se akti akdiminstrativ duhet të jetë i arsyetuar për spjegimin e situatës faktike, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare si dhe bazën ligjore, kurse vendimi i AK datë 15.08.2023 nuk plotëson asnjë prej këtyre kushteve ligjore, për shkak se nuk kemi as edhe një fjali të vetme lidhur me arsyetimin e pretendimeve të palës ankuese, as një vlerësim të asnjë provë apo faktit vendimtar dhe nuk kemi as edhe një citim të dispozitave ligjore, e që në mënyrë automatike ky vendim është edhe i kundërligjshëm edhe duhet anuluar në tërësi.

Mbështetur në nenin 52 paragrafi 1.4 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet se akti administrativ është i paligjshëm nëse: "*është nxjerr në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ*", gjë që vendimi i dt.15.08.2023, konform këtyre dispozitave është në tërësi i paligjshëm, pasi që nuk ekziston asnjë rrethanë apo provë që dëshmon se sulfuri është produkt i ndaluar, përkundrazi ekzisotjnë dëmshmi se ky produkt pikërisht është i lejuar e këtë fakt nuk e ka vërtetur AK.

Nga shqyrtimi i kësaj ankese, provat e bashkëngjitura, dispozitat e shkelura ligjore, kërkesat e dosjes së tenderit konstatohet në mënyrë të pakontestueshme se OE Ankues ka të drejtë lidhur me pretendimet e ngritura, që të gjitha këto pretendime në një analizë të mirëfillt të provave dhe bazës ligjore dëshmojnë shkeljet e bëra nga AK dhe domosdoshmerinë e anulimit të vendimit të AK.

PROPOZIM

Që Organin Shqyrtues të Prokurorimit, me seli në Prishtinë, ta APROVOJ ankesën si të BAZUAR, Vendimin e dt. 15.08.2023 të AK Komuna e Prishtinës – Departamenti i Prokurorimit që të njëjtin ta PRISHË dhe çështja të kthehet në rivendosje në organin e shkallës së parë.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë të njëjta.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**Kërkesa 1: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK-së , se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit ka qenë në vlerë, se bashku në të tri vitet, prej jo më pak se 200,000.00 euro.**	**Dëshmia 1. OE duhet te dëshmojë me deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e fundit prej jo më pak se 200,000.00 euro..**
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kërkesa 1. Stafi profesional për shërbimet e DDD:3 Punëtorë teknik**	**Dëshmia 1. Listën e stafit profesional për shërbime të DDD nënshkruar dhe vulosur nga OE.Minimum Tre (3) punëtorë teknik me eksperiencë në lëminë e DDD-së. Me Dy (2) vite përvojë pune të dëshmuar me referencë . Me Kontratë pune ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin për angazhim për këtë projekt.**
		Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e shkuara në vlerë prej 100,000.00 € deri në publikimin e njoftimit për kontratë.	**Dëshmia 2. Një Listë e Shërbimeve të natyrës se ngjashme të realizuara në tri vitet e shkuara duke saktësuar Shërbimet e kryera , shumën e kontratës vendin, datën si dhe nr. e prokurimit, kjo listë duhet te jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga kompania (origjinal), të dëshmuara me referenca pozitive ose raportet e pranimit si dëshmi se kontrata është përmbushur me sukses. (kopje).**
		Kërkesa 3. OE duhet të dorëzoj metodologjinë e punës dhe preparatet e parapara për përdorim.	**Dëshmia 3. Përshkrimi i detajuar i Metodologjisë se punës dhe preparatet për realizimin e shërbimeve. Vërejtje të gjitha preparatet e parapara duhet të jenë të lejuara me ligj.**
		Kërkesa 4. OE duhet ta ofrojë listën mbi mjetet e punës e nënshkruar dhe vulosur nga OE me pajisjet ne vijim **Së paku 1 pompë motorike – Gjenerator ULVSë paku 5 pompa motorike dhe pajisje të tjera përcjellëse.**	**Dëshmia 4.OE duhet të ofrojë listën e pajisjeve të kërkuara për kryerjen e shërbimeve e nënshkruar dhe e vulosur nga OE. Në rast se këto pajisje janë të vetat, atëherë duhet të dëshmohet me foto dhe deklaratë mbi posedimin e tyre, nëse janë të marra me qera atëherë te dëshmohet me marrëveshje mbi marrjen me qera për projektin në fjalë.**
		Kërkesa 5. OEduhet të ofroj Katalog ose broshurë për të gjithë artikujt me të cilën është e mundur vlerësimi i specifikave teknike të ofruara.	**Dëshmia 5. Katalog ose broshurë për të gjithë artikujt me detaje të mjaftueshme për vlerësim.**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

DEKLARATË

Policia e Kosovës anulon aktivitetin e prokurimit ne pajtim me nenin 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit pas hapjes se ofertave l
shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përm
amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të pr

Arsyetim Komisioni i vlerësimit duke ju referuar vendimit te OSHP-së me numër 2023/0283 te datës 24/07/2023 I cili e obligon AK P
Kosovës qe te veproje si ne vijim citoj "andaj paneli shqyrtues konform gjendjes së krijuar e klasifikon pjesërisht te bazuar ankesën e
Obligon autoritetin kontraktues Policia e Kosovës qe gjate fazës se ri-vlerësimit fillimisht te beje hulumtim te këtyre preparateve me s
aktive te ngritura ne pretendimet ankimore ne ankesën 283/2023, dhe pas një konstatimi te saktë nëse këto preparate janë te lejuar atëh
filloje te beje ri-vlerësimin e ofertave ne te kundërtën ta anuloje aktivitetin e Prokurimit pasi vije ne shprehje shëndeti publik. Pastaj n
interes ta ri-tenderojë dhe ti beje përmirësimet e domosdoshme ne dosjen te tenderit.
Sipas ekspertizës dhe sipas gjendjes se ofertave te dorëzuar dhe produktet e tyre nuk lejohet përdorimi tyre sipas ndryshimeve te rregu
ndërkombëtarë, po ashtu pas konfirmimit nga ministria përkatëse se këto preparate janë të ndaluara.
AK sipas vendimit te OSHP ka kontaktuar me ministrin përkatëse te cilit na konfirmojnë se produkti i ofruar për repelent me substanc
sulfur dhe me përqindje pre 28% nuk është i lejuar te përdoret më dhe ne përgjithësi nuk lejohet qe sulferi te jetë substance primare.
Andaj AK pas situatës se krijuar është e pamundur vlerësim i drejt i ofertave dhe respektim i nenit 7 te LPP dhe nenit 59 pasi nuk mun
gjithë ofertuesit ti trajtojmë te barabartë dhe vlerësimi sipas nenit 59 është i pamundur.
Duke pasur parasysh shëndetin publik dhe ne veçanti shëndetin e zyrtarëve Policor AK anulon aktivitetin e prokurimit ne tërësi dhe m
rishikoje specifikat teknike për te ritenderuar me pas..

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Sqarimet e marra përmes emailit te datës 04.09.2023 dhe 06.09.2023 nga AK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi i OSHP me nr. 2023/0283 i datës 24.07.2023

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.**

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Sqarim: Për këtë aktivitet te prokurimit është shpallur fitues OE Doctor Exterminator me datën 27.04.2023. Pas ankesës ne OSHP të disa OE pjesëmarrës të aktivitetit të prokurimit është marr vendim nga PSH me nr. 2023/283. AK-ja pas sqarimeve të marra nga MMPH ka anuluar aktivitetin e prokurimit në tërësi.

Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te beje me importin e produktit te sulfurit dhe vendimin e AK-se per anulimin e aktivitetit te prokurimit eksperti shqyrtues sqaron se kërkesë te dosjes se tenderit është:

Largimi i zvarranikëve – Për kryerjen e këtij shërbimi të përdoret njëri lloj i këtyre aparateve apo vetëm granulat.

1 - Aparate me vibrim për dëbimin e zvarranikëve me bateri që vendosen në tokë.

- Sipërfaqja 300 - 400 m² për largimin e Zvarranikeve, të qëndrueshëm ndaj lagështisë. ose

2 –Aparate solare me vibrim për dëbimin e zvarranikëve që vendosen në tokë.

- Sipërfaqja 600 – 700 m² për largimin e Zvarranikëve të qëndrueshëm ndaj lagështisë.

3 – Preparate repelente ekologjike si granula për largimin e zvarranikëve me efektivitet optimal.

Për çështje të sigurisë së tyre në lidhje me origjinën e produkteve tenderuese dhe lejen për përdorim në RK,duhet të paraqesë edhe lejen e importit të produkteve të lëshuar nga Ministria e Ambientit Hapësinor në RK.

Sa i përket pjesës se pretendimit të OE ankues që ka të bëjë me importin e produkteve biocide dhe sqarimit se a janë te ndaluara produktet sipas listës se zyrtareve te MMPH eksperti shqyrtues vlerëson se zyrtarët e AK-së kanë sqaruar përmes komunikimit zyrtar me zyrtaret e MMPH se produktet sipas "Material Safety Data Sheet" me nr ID 875-25b kane ndryshuar ne përmbajtje te komponentëve te rrezikshme dhe se përqindjet e lejuara tani janë dukshëm me te ultë se me lejen e importit qe OE pjesëmarrës te aktivitetit te prokurimit kanë në posedim.

Hazardous Components (Specific Chemical Identity: Common Name(s)	OSHA PEL	ACGIH	TLV	Other Limits	% (Optional)
Cinnamon Oil (CAS # 8015-91-6)	N/A				0.6%
Clove Oil (CAS # 8000-34-8)	N/A				0.3%
Cedar Oil (CAS # 68990-83-0)	N/A				3.1%
Sulfur (CAS # 7704-34-9)	N/A				10.0%

OE ankues ne ofertën e tij ka ofruar produkt me përmbajtje te sulfurit 28% derisa me rregullat e sqaruara me larte kjo përmbajtje ka rene ne 10%.

Vlen te theksohet se ne dosje te tenderit nuk është kërkuar përmbajtja e produkteve apo "Safety Data Sheet" për produktet e ofruara nga OE pjesëmarrës ne aktivitet te prokurimit.

Eksperti shqyrtues pas administrimit te provave, dosjes se tenderit, ankesat e OE qe nga inicimi i aktivitetit te prokurimit, vendimeve te PSH vlerëson se është me rëndësi qe të shpalosen edhe fakti se

ky aktivitet i prokurimit është shpallur me 10.06.2022. Nga kjo periudhe ka pas ndryshime ne rregulloret e aplikuara për produktet qe përdoren nga OE-te pjesë e aktivitetit te prokurimit.

Duke pas parasysh përmbajtjet e produkteve dhe rrezikshmërinë e tyre për shëndetin publik eksperti shqyrtues e potencon faktin se OE pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit eshte kerkuar qe të posedojnë licencë për importin e këtyre produkteve. Licencat e dorezuara me ofertë janë si më poshtë:

GOE SV Veterina – NNP WENDA: Safet Osmani BI (SV Veterina) – Leja për kryerjen e shërbimeve DDD nga Departamenti i politikave Bujqësorë dhe Tregtisë me nr. 04.5-54/23 i datës 20.01.2023 – **skaduar me 20.07.2023**.

Licenca e MMPHI për import te produkteve biocide me nr 22/226/-1-ZSP e **skaduar me datën 22.04.2023.**

DR Exterminator DDD: licenca e importit nga MMPHI për produkte biocide me nr 22/2940/-1-ZSP **e skaduar me datën:15.06.2023.**

Leja për kryerjen e shërbimeve DDD nga Departamenti i politikave Bujqësorë dhe Tregtisë me nr. 04.5-479/22 **skaduar me 04.05.2023.**

GOE Vlera Shpk – EGIAN MED Shpk: Licenca e MMPHi për produkte biocide me nr 22/5371/-1-ZSP **skadon me datën 27.10.2023**

Leja për kryerjen e shërbimeve DDD nga Departamenti i politikave Bujqësorë dhe Tregtisë me nr. 04.5-516/22 **skaduar me 16.06.2023.**

Flomed Shpk: Licenca e MMPHi me nr 22/6162/-1-ZSP për produkte biocide **skadon me datën 20.09.2023**

Leja për kryerjen e shërbimeve DDD nga Departamenti i politikave Bujqësorë dhe Tregtisë me nr. 04.5-502/22 **skaduar me 25.05.2023.**

Monuni Shpk: Licenca e MMPHi me nr 22/2117/-1-ZSP për produkte biocide **skadon me datën 31.05.2023**

Leja për kryerjen e shërbimeve DDD nga Departamenti i politikave Bujqësorë dhe Tregtisë me nr. 04.5-478/22 **skaduar me 04.05.2023.**

Mburoya Shpk – Vector Pest Control: Licenca e MMPHi me nr 22/2326/-1-ZSP për produkte biocide **skaduar me datën 31.05.2023**

Leja për kryerjen e shërbimeve DDD nga Departamenti i politikave Bujqësorë dhe Tregtisë me nr. 04.5-481/22 **skaduar me 07.04.2023.**

Prandaj duke u bazuar ne faktin se ka kaluar një kohë relativisht e gjatë dhe se OE pjesë të aktivitetit të prokurimit të gjithë posedojnë një apo të gjitha licencat e skaduara dhe sqarimet e zyrtarit te MMPH se përmbajtja e produkteve biocide pjesë e licencës do të ndryshojë në përputhje me rregulloret e reja në fuqi dhe se çdo licencim do te behet me rregulla qe kanë ndryshuar eksperti

shqyrtues vlerëson se AK më të drejtë ka vlerësuar se vjen ne shprehje shëndeti publik dhe se çdo rivlerësim i ofertave ne këtë fazë nuk do të mund të bëhet në përputhje me LPP-në **Neni7 BarazianëTrajtim/Jo-Diskriminimi, Neni59 Ekzaminimi,VlerësimidheKrahasimiiTenderëve, si dhe RRPP 001/2022 Neni 4 Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit.**

Vazhdimi i lejes se importit e cila tani ne përmbajtje ndryshon dukshëm bien ne kundërshtim me nenin 59 paragrafi 2 te LPP-se Autoritetikontraktuesmundetqë meshkrimtëkërkojënganjëtenderuesqëtësigurojënjë sqarimmeshkrimmbicilindongaaspektetetenderittëtij,në mënyrëqëtëbëhetekzaminimi, vlerësimiosekrahasimiitenderëve.**Asnjëndryshimmaterialdheasnjëaspektitenderitnuk duhet tëkërkohenosepranohen nga autoriteti kontraktues osetë ofrohen nga njëtenderues.**

Poashtu dorëzimi i vazhdimit te lejës se importit nga të gjithë OE pjesë të aktivitetit të prokurimit do te binte ndesh me nenin 72 paragrafi 3 i LPP-se Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Si përfundim eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues nuk është i bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.**

Burim Zeka